VENDIM
Nr. 880, datë 17.12.2014

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 53, DATË 21.1.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 3, e 75, të ligjit nr. 9643, datë 21.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Integrimit Evropian, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1, të vendimit nr. 53, datë 21.1.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Përjashtimisht për vitin 2015, lejohet Ministria e Integrimit Evropian të realizojë vetë procedurat e prokurimit për:

a) blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash;

b) blerje pajisjesh elektronike dhe tele-komunikacioni;

c) shërbim lyerje ndërtesash.

Në procedurat e prokurimit përfshihen lidhja e kontratave përkatëse dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike."

2. Ngarkohen Ministria e Integrimit Evropian dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama